



VENDIMI I PAPRANUESHMËRISË

Data e miratimit: 07.12.2010

Nr. i rastit 2010-14

Zotëri Lulzim Gashi

kundër

EULEX-it

Paneli për Rishikimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 8 dhjetor 2010, ku të pranishëm ishin personat e paraqitur në vijim:

Zotëri Antonio BALSAMO, Kryesues
Zonja Magda MIERZEWSKA, anëtare
Zotëri Francesco FLORIT, anëtar

Asistuar nga
Zotëri John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor
Zonja Leena LEIKAS, zyrtare ligjore

Pas shqyrtimit të ankesës, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it i 29 tetorit 2009 për themelimin e Panelit për Rishikimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullave në Punës së Panelit me 9 qershor 2010,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURAT PARA PANELIT

1. Parashtruesi i ankesës së pari ka kontaktuar Panelin më 7 korrik 2010 përmes postës elektronike. Ai është njoftuar se nuk është në mandat të PShDNj t'i shqyrtoj procedurat e punësimit të EULEX-it, dhe ai ishte këshilluar t'i kontaktonte Burimet Njerëzore të EULEX-it.
2. Më 20 shtator 2010, ankuesi ka kontaktuar prapë me Panelin dhe siç është udhëzuar, ankesa e tij ishte pranuar dhe regjistruar më 27 shtator 2010.

II. FAKTET

3. Parashtruesi i ankesës ka aplikuar për një vend pune në EULEX në vitin 2008. Ai as nuk është zgjedhur e as nuk është futur në listën e ngushtë për intervistë, sipas aplikacionit të tij. Më pastaj, ai ka kontaktuar EULEX-in, Ombudspersonin dhe UNMIK-un, të cilët nuk kanë pasur mandat për të shqyrtuar një ankesë të tillë, e as nuk e kanë marrë pretendimet e tij mjaft të mbështetura për tu hetuar.

III. ANKESAT

4. Parashtruesi i ankesës pretendon se procedura e rekrutimit të EULEX-it është e korruptuar dhe jo e drejtë. Sipas tij, persona më pak të kualifikuar se ai janë pranuar në punë përmes lidhjeve personale mes tyre apo përmes marrëveshjeve të ndryshme në mes të personelit që është në krye të procesit të rekrutimit dhe personave që aplikojnë për vende pune në EULEX.

IV. LIGJI

5. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendos se a do ta pranojë atë, duke marrë parasysh kriterin e pranueshmërisë të përcaktuar në Rregulloren 29 të Rregullores së Punës.
6. Sipas Rregullores 25, paragrafi 1 i Rregullores së Punës, Paneli mund të shqyrtoj ankesat që lidhen me shkeljet e të drejtave të njeriut gjatë kryerjes së mandatit ekzekutiv.
7. Çështja që është ngritur në këtë ankesë lidhet me procedurat e rekrutimit të EULEX-it, prandaj kjo nuk i takon fushës së mandatit ekzekutiv të EULEX-it, të cilat përqendrohen në çështjet e caktuara që lidhen me drejtësinë, policinë dhe doganat.

PËR KËTO ARSYE,

Paneli njëzëri konsideron se mungon fuqia ligjore për të shqyrtuar ankesën, konstaton se ankesa është e pabazuar sa i përket Nenit 29 (d) të Rregullores së Punës, dhe

SHPALL ANKESËN TË PAPRANUESHME.

Për Panelin,

John J. RYAN
Zyrtar i lartë ligjor



Antonio BALSAMO
Kryesues i Panelit